

Të nderuar studentë,

Nga data 5 deri më 9 tetor 2020 do të zhvillohen regjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave “Në Fushën e Shkencave Sportive”.

Çfarë përfaqëson ky program studimi:

Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ky institucion ka një traditë mbi 60 vjeçare për formësimin e profesionistëve të edukimit fizik të cilët kontribuojnë në këtë sektor me shumë kompetencë. Në përfundim të studimeve master studentët pajisen me një diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave me 120 kredite. Kohëzgjatja normale e studimeve është 2 vite akademike.

Hapja e Masterit Shkencor përbën një eksperiencë unike për vetë UST-në. Ky master është formësuar falë bashkëpunimit ndërkombëtar, në kuadër të projektit TEMPUS, konsorcium ndërkombëtar i të cilit kryesohej nga Universiteti i Romës “Foro Italico” në bashkëpunim me Universitetin e Vienës, Universitetin e Danimarkës Jugore, Universitetin Norvegjez të Sportit si dhe Universitetin Kombëtar e Kapodistrian të Athinës për të ofruar edukim të thelluar në fushën e Shkencave Sportive për të gjithë studentët që kanë mbaruar programin e studimeve Bachelor në “Shkencat Sportive” dhe të ngjashme me të në çdo universitet shqiptar apo të huaj.

Në këtë program studimi mund të regjistrohen të gjithë kandidatët e pajisur me diplomë bachelor në “Edukim Fizik” dhe që zotërojnë një certifikatë të testeve ndërkombëtare të një ndër pesë gjuhëve të huaja, bazuar në ligjin e arsimit të lartë. Gjithashtu kandidatë potencial janë të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e organizatave sportive si të federatave të sporteve të ndryshme; klubeve sportive; shoqatave të ndryshme të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sport; të gjithë ata që aspirojnë të kenë një karrierë akademike si pedagog apo kërkues shkencor; të gjithë ata që dëshirojnë të punojnë në administratën shtetërore; të gjithë kandidatët që dëshirojnë të ndjekin studimet doktorale në fushën sportive.

Sektori sportiv, i edukimit fizik dhe shëndetësor është duke u bërë gjithnjë e më tepër konkurues dhe kompleks lidhur me çështjet e drejtimit dhe menaxhimit. Nga ana tjetër, UST është i vetmi institucion i cili ofron program studimi të këtij lloji dhe për më tepër edhe studimet doktorale.

Mundësitë e punësimit:

1. Drejtues dhe punonjës në organizata sportive si federata të sporteve të ndryshme; klube sportive; shoqata të ndryshme të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sport.
2. Pedagog apo kërkues shkencor pranë UST si dhe pranë Departamentit të Edukimit Fizik/Sportit të Universiteteve të tjera publike dhe private si Universiteti i Elbasanit, Korcës, Shkodrës, UET, Marin Barleti.
3. Administratën shtetërore, në të gjitha nivelet.

Kriteret e pranimit:

Kandidatët duhet të zotërojnë një çertikatë të testeve ndërkombëtare të një ndër pesë gjuhëve të huaja bazuar në ligjin e arsimit të lartë në nivelin B1.

Përfitime të tjera që sjell programi:

- Aftësi lidhshpi dhe rritje e bashkëpunimit efektiv në mjediset e organizatave sportive.
- Mundësi të shumta punësimi në administratën shtetërore.
- Rritje të kapaciteteve akademike dhe të kërkimit shkencor.
- Rritje të networkut personal përmes një ndërveprimi të ngushtë midis pedagogëve dhe kolegëve.
- Përbushje e një ndër kriterëve bazë për të ndjekur studimet në “Doktoraturë” dhe vazhduar më tej eksperiencën akademike.

JENI TË MIRËPRITUR!